Në tabelën prej 1 deri në 7 pikë, ku 1-shi paraqet nivelin më të ulët të përparimit demokratik dhe 7-ta me të lartin, Kosova i ka 3.14 pikë, në krahasim me 3.18 sa ka pasur vitin e kaluar. Sa iu përket vendeve të rajonit, Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia, kanë shënuar rënje po ashtu, derisa Maqedonia e Veriut dhe Bosnje-Hercegovina kanë shënuar përparim. Kroacia nuk ka ndërruar pikët.

Në raport është thënë se në përgjithësi viti 2020 nuk ka qenë i mirë për reforma dhe në shumë vende ku ka pasur shpresë për ndryshim, mundësia është flakur tutje.

Aty përmendet se ndonëse në Kosovë dhe në Mal të Zi ka pasur transferime të rëndësishme të pushtetit, ende nuk është e qartë nëse ndryshimet do të ndikojnë në përmirësim të institucioneve

demokratike.

Raporti përmend edhe rritjen e shkallës së daljes në zgjedhje në Kosovë, përkatësisht 3.4 për qind më shumë më 2019 dhe 7.7 për qind më 2021, në krahasim me zgjedhjet parlamentare të vitit 2017. "Ndonëse fitorja e Partisë Vetëvendosje përbën shkëputje të mirëfilltë nga status quo-ja, mbështetja që ka kjo parti për bashkim me Shqipërinë, mund ta trazojë gjithë rajonin", kanë thënë hartuesit e rapportit.

Përveç Kosovës, dalje më e lartë në zgjedhje është regjistruar edhe në Mal të Zi, mirëpo e kundërtë është thënë të ketë ndodhur në Kroaci, Maqedoni të Veriut dhe Bosnie-Hercegovinë.

Në raport përmendet edhe se ndonëse Kosova ka vite që përfshihet në mesin e vendeve me regjime hibride, Hungaria, Mali i Zi dhe Serbia vetëm së fundmi janë klasifikuar si të tilla.

Përpiluesit e rapportit kanë përmendur Kosovën bashkë me Malin e Zi, Moldavinë dhe Sllovaninë, kur kanë qenë në pyetje shifrat e dobëta sa iu përket vlerësimi për korruption. Regimi më i shpeshtë në



Ballkan vazhdon të mbetet "hibrid/kalimtar". Përjashtim bën Kroacia, e cila konsiderohet demokraci gjysmë e konsoliduar. Në raportin e sivjetshëm të organizatës ndërkombëtare "Freedom House", të titulluar "Kombet në Tranzicion 2021: Kthesa antidekomratike", është vlerësuar se liderët e zgjedhur në Evropë dhe

Euroazi janë duke dëmtuar edhe institucionet që i kanë dërguar vetë ata në pushtet, duke refuzuar normat demokratike dhe duke promovuar sisteme alternative të qeverisjes autoritare. Sipas tij, në Evropë dhe Euroazi ka më pak demokraci sesa në secilën pikë, prej njës së hartimit të këtij raporti 26 vjet më parë. Nga 29 vendet e

analizuara, 10 janë cilësuar demokratike, 10 hibride dhe nëntë autoritare. Asnjë shtet nuk ka ndryshuar kategorinë këtë vit.

Ky raport ka analizuar qeverisjen në 29 shtete nga Evropa Qendrore deri në Azinë Qendrore. Rezultatet për secilin shtet bazohen varësisht nga ngjarjet që kanë ndodhur në periudhën janar-dhjetor 2020.

Netflix shton Kosovën në listën e shteteve



PRISHTINË, 28 PRILL - Kompania amerikane "Netflix" ka shtuar Kosovën në platformën e saj me kodin telefonik +383 ka bërë me dije Sovran Hoti përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", i cili dy muaj më parë pati nisur një fushatë për njohje të Kosovës nga kjo kompani.

Ai ka thënë se pas 37 mijë nënshkrimeve, Netflix ka dëgjuar kërkesën e atyre që kanë nënshkruar petitionin. "Presim të pasojë e njëjtë edhe përvendndodhjen e përdoruesve kosovarë", ka thënë Hoti, duke treguar arsyen e ndërmarrjes së kësaj iniciativë. "Kjo iniciativë lindi pasi që në kohën e pandemisë, duke e përdorur 'Netflixin', më shumë sesa në kohët e mëparshme, ndodhi që e shihja

shumë shpesh lokacionin tim si vendndodhje në Serbi", ka thënë Hoti.

Ai ka thënë se kjo gjë i ka penguar, andaj ka kërkuar ndihmën e gjithë qytetarëve të Kosovës. Mirëpo problemi i identitetit digital të Kosovës nuk është problem i ditëve të sotme.

Prej vitit 2008, kur Kosova ka shpallur pavarsinë, ajo vazhdon të mos ketë kodin e saj në internet. Prandaj kur qytetarët qasen në internet nga territori i Kosovës IP-adresat e tyre lidhen me ato të vendeve të rajonit si Shqipëria, Serbia apo Maqedonia e Veriut. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Kosovës ka thënë muaj më parë se ndarja e domenit përbën një proces të gjatë negociatash.

Abdixiku e njofton Von Cramonin për zhvillimet politike në Kosovë


PRISHTINË, 28 PRILL (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixiku, ka zhvilluar një takim virtual me reportuesen për Kosovën

në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon - Taubadel.

Abdixiku e ka njoftuar Von Cramon për situatën e përgjithshme politike në

vend, priorititet e tij, sfidat me pandeminë, si dhe qasjen e LDK-së si opozitë lidhur me ngjarjet krujiale me të cilat ballafaqohet Kosova. Gjatë takimit virtual

u diskutua edhe për procesin e dialogut Kosovë - Serbi dhe për rolin e LDK-së karshi këtij procesi. Të dyja palët shprehën interesim për thellimin e bashkëpunimit.



Komuna e Drenasit angazhohet për integrim të fëmijëve në proces të rregullt arsimor

DRENAS, 28 PRILL (ER) - Të mërkurën është mbajtur mbledhja e rregullt e Ekipit Komunal e Drenasit për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar (EPRBM), ku është diskutuar për rastet me tendencë për braktisje të mësimit nga nxënësit e shkollave në këtë komunë. Ekipi komunal në këtë takim ka trajtuar veçanërisht mundësinë e krijimit për një integrim sa më të shpejtë dhe të sigurt të

fëmijëve me proces të rregullt edukativo arsimor. Ekipi ka hartuar edhe planin dhe strategjinë e funksionimit të kësaj trupe në nivel komune për ta mbrojtur dhe parandaluar braktisjen e nxënësve. "Ekipi komunal gjatë kohës së funksionimit ka trajtuar disa raste në tri shkollat e Drenasit, me tendencë për braktisje, por nga kontributi i ekipit komunal me kohë, nxënësit sot vijojnë mësimin e rregullt në procesin mësimor", ka njoftuar Komuna e Drenasit.



Shoqata Humanitare 'Busavata' dhuron shtretër dhe karrige për shëndetësinë në Kamenicë



KAMENICË, 28 PRILL (ER) - Komuna e Kamenicës ka pranuar donacion me shtretër dhe karrige për sektorin e shëndetësisë. Ky donacion është dhuruar nga Shoqata Humanitare 'Busavata', e përfaqësuar nga bashkatdhetari Asllan Maliqi. I pari i komunës, Qëndron Kastrati, duke

falënderuar Shoqatën Humanitare 'Busavata', ka thënë se diaspora çdoherë ndihmon me pajisje e mjete të cilat janë në shërbim të qytetarëve. "Sot pranuam donacionin me shtretër dhe karrige për shëndetësinë. Diaspora vazhdimisht po na del në ndihmë me pajisje e mjete të

cilat do të janë në shërbim të qytetarëve të Kamenicës. Për donacionin në fjalë falënderojmë jashtëzakonisht shumë bashkatdhetarin tonë Asllan Maliqi dhe Shoqatën Humanitare 'Busavata', e që nuk është hera e parë që po sjellin donacione", është shprehur Kastrati.

Nis ndërtimi i shëtitores te pishat në Gadime

LIPJAN, 28 PRILL (ER) - Kanë filluar punimet për ndërtimin e shëtitores te pishat në Gadime të Lipjanit. Fillimin e punimeve nga afër e ka përcjellë kryetari i kësaj komune, Imri Ahmeti, i cili ka thënë se ndërtimi i shtegut të ecjes do ta ketë edhe shtegun e biçikletave dhe ndriçimin publik për banorët e këtij regjioni. "Ne sot filluam investimin në këtë projekt i cili do të plotësohet me infrastrukturë të nevojshme.

Qytetarët shumë shpejt do të kenë mundësi t'i shijojnë në këtë shëtitore bukuritë e rralla natyrore, pishat dhe ajrin e freskët. Kjo zonë gjelbëruese me një pamje të mirë së shpejti do të jetë në shërbim të shëndetit e të rekreacionit të qytetarëve jo vetëm të Gadimes, por edhe më gjerë", ka thënë kryetari Imri Ahmeti. Ky projekt do të financohet nga Komuna e Lipjanit dhe do të kushtojë rreth 180 mijë euro.



Fillon ndërtimi i fushës së sportit në Shkozë të Malishevës

MALISHEVË, 28 PRILL (ER) - Ditë më parë në fshatin Shkozë të Komunës së Malishevës ka filluar ndërtimi i fushës së sportit për nxënësit e shkollës dhe rininë e fshatit. Punimet për ndërtimin e fushës së sportit i kanë parë nga afër nënkyetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha. Ndërkëq drejtori i Urbanizmit, Ahmet Morina, ka thënë se kjo fushë e sportit, për shkak të specifikave të terrenit, do të kushtojë rreth 70 mijë euro dhe e tëra mundësohet nga buxheti i Komunës së Malishevës. "Ndërtimi i kësaj

të gjithë nxënësit, por edhe për rininë e fshatit Shkozë. Do të kujdesemi që kjo fushë të ndërtohet sipas parametrave të paraparë dhe standardeve përfushat e vogla sportive", ka thënë nënkyetari i komunës, Hajdin Berisha.



Takimet B2B, mundësi e mirë e lidhjes së bizneseve mes vete për të krijuar qëndrueshmëri

GJILAN, 28 PRILL (ER) - Në Komunën e Gjilanit është mbajtur të mërkurën punëtoria përmes projektit të përkrahjes së Bashkimit Evropian për konkurrueshmërinë e sektorit kosovar ICT-së, i cili ka qëllim mbështetjen dhe nxitjen e konkurrencës në sektorit privat në fushën digitale dhe prodhimeve tradicionale, për të ndikuar kështu në zhvillimin ekonomik.

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se takimet B2B janë një mundësi e mirë e lidhjes së bizneseve mes vete për të krijuar qëndrueshmëri dhe ngritje të sigurt që nga përpunimi i ushqimit dhe produkteve të ndryshme e deri te prodhimi dhe përpunimi i drurit dhe interierit deri te përdorimi i teknologjisë dhe inovacionit. "Komuna e Gjilanit mbetet e vendosur për zhvillimin e sektorit të prodhimeve vendore dhe

agroprodukteve në përgjithësi. Këtyre ditëve kemi inauguruar Inkubatorin e Agrobiznesit dhe jemi të vendosur që bashkërisht atë ta bëjmë një shembull të mbështetjes për sektorin privat në të ardhmen. Po ashtu, prodhuesit gjilanas që janë të njojur tashmë i bëjnë vazhdimisht nder Gjilanit me produktet e tyre në tregjet e njoitura evropiane e botërore. Komuna e Gjilanit është kujdestare e mbështetjes për sektorin privat në përgjithësi. Gjilani është prodhues i eksperimenteve të rinj në fusha të ndryshme dhe në IT që është, po ashtu, një përparsi i madhe", ka thënë kryetari Haziri. Ahmet Jetullahu, nga projekti i ICT-së, ka thënë se angazhimi i përbashkët përmes mbështetjes së Bashkimit Evropian, institucioneve të qeverisjes në Kosovë dhe sektorit privat, që bashkërisht



të bëhet një zhvillim i qëndrueshëm ekonomik përmes aftësimit dhe trajnimeve për sektorë të ndryshëm, që janë baza e suksesit të një biznesi. Në këtë rrugë është punuar jashtëzakonisht shumë nga ICT-ja në Kosovë që t'i

ndihmojë bizneset dhe thënë se ky takim mes bizneseve është jashtëzakonisht i mirëseardhur dhe ndihmon shumë për zhvillimin ndërsektorial dhe njëkohësisht edhe për depërtimin në tregjet evropiane që janë mundësuar përmes ICT-së.

Agron Namani nga Ask Food ka

TIKA me program të veçantë mbështetës për prodhuesit e qumështit në Kosovë

PRISHTINË, 28 PRILL - Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) ka siguruar mbështetje me pajisje për prodhuesit e qumështit në Komunën e Rahovecit të Kosovës në kuadër të projektit "Mbështetja e Shoqatës së Prodhesve të Qumështit të Kosovës me makineri për pastrimin e thundrave të gjedheve".

Në ceremoninë e zhvilluar në bashkëpunim me Shoqatën e Prodhesve të Qumështit të Kosovës morën pjesë ambasadori i Turqisë në Prishtinë, Çagri Sakar, koordinatori i TIKA-s në Prishtinë, Cihan Dinçer, kryetari i Shoqatës së Prodhesve të Qumështit të Kosovës, Milazim Berisha dhe shumë prodhues të tjera të qumështit.

Ambasadori Çagri Sakar ka theksuar rëndësinë e mbështetjes që TIKA ofron për zhvillimin ekonomik të Kosovës nëpërmjet projekteve që ajo zhvillon. "Me makineritë për



pastrimin e thundrave të gjedheve që janë dhuruar sot, do të përmbyshen nevojat e mbi 2 000 prodhesve të qumështit. Uroj që kjo të jetë e dobishme për Kosovën", ka thënë Sakar.

Kryetari i shoqatës, Milazim Berisha, ka shprehur kënaqësinë për mbështetjet e TIKA-s ndaj fermerëve të Kosovës. "Besoj se do të ketë edhe projekte të tjera për të mirën e fermerëve.

Falënderoj edhe ambasadorin i cili ka marrë pjesë në ceremoninë e shpërndarjes së pajisjeve për mirëqenien e fermerëve", ka thënë ai. Koordinatori i TIKA-s në

Prishtinë, Cihan Dinçer, ka thënë se makineritë e prodhuara nga njerëz të biznesit turk do të ofrojnë kontribut të rëndësishëm për prodhuesit e qumështit në Kosovë.

Më 11 maj fillojnë dëgjimet publike në Prizren për kornizën afatmesme buxhetore

PRIZREN, 28 PRILL (ER) - Komuna e Prizrenit do të organizojë katër dëgjime publike lidhur me kornizën afatmesme buxhetore 2022-

2024, ku do të merren propozimet dhe kërkesat e qytetarëve lidhur me projekteet dhe shërbimet komunale. Këto dëgjime do

të organizohen me pjesëmarrje të kufizuar fizike për shkak të situatës pandemike, ndërkarak për të mundësuar sa më shumë

pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje, këto dëgjime do të organizohen edhe në formën "online" përmes aplikacionit "Zoom".



CERN dhe FERMILAB kërkojnë forcën e pestë fundamentale të fizikës, që tashmë është zbuluar nga fizikani Naim Krasniqi (4)

Përbledhje e shkurtër e botimeve në "Epoka e re" 2016, 2019 dhe 2020



Nga: Naim KRASNIQI,
fizikan

Para se të sqarohet se çka përbajnjë botimet në "Epoka e re" gjatë këtyre viteve, le të nisemi nga raportet e qendrave hulumtuese shkencore CERN dhe FERMILAB. Në këto raporte theksohen qartë fjala (një), çka do të thotë se janë afër zbulimit të a) (Një) grimce të re. Fjala është përvetëm një grimcë të re apo grimcën e 13. b) (Një) forcë të re që do të thotë se janë afër zbulimit të vetëm një forcë të pestë fundamentale të fizikës. Ndërsa përvetëm dallim nga këto qendra hulumtuese shkencore unë them se zbulimet e mia që janë publikuar në këto botime gjatë këtyre viteve kanë të bëjnë jo me një (1) grimcë por me tri (3) mikrogrimca të reja që i formojnë dy forca fundamentale repulsive të fizikës, e cila njëra vepron në makrobotë dhe tjetra vepron në mikrobotë, si dhe tri (3) mikrogrimcat e zbuluara nga unë janë të publikuara në "Epoka e re" më 27/01/2020.

Mikrogrimcat (β'), (δ') dhe (μ')

Këto mikrogrimca janë sqaruar në botimet e "Epoka e re" në botimin e 11 të datës 27 janar 2020. Shkëpusim një pjesë nga ky botim.

Mikrogrimcat (β'), (δ') dhe (μ') janë të ndryshme nga mikrogrimcat (β), (δ) dhe (μ) dhe (β''), (δ'') dhe (μ''), sepse protonet, elektronet dhe

neutronet i prodhojnë këto mikrogrimca atëherë dhe vetëm atëherë kur polet e magnetit mbulohen me materiale feromagnetike. Edhe pse këto mikrogrimca burojnë nga pjesa anësore e magnetit shpërndahen në të gjitha anët duke formuar një formë sferike rreth magnetit me një reze të caktuar (R) e cila varet nga niveli energetik i mikrogrimeve (β'), (δ') dhe (μ'), dhe kohës së qëndrimit të materialeve feromagnetike mbi polet magnetike.

Sqarim

Pasi këto botime kanë të bëjnë me fushën simetrike të magneteve këtu bazuar në eksperimente sqarohet saktë se në momentin kur mbulohen polet e magnetit me pllaka të materialeve feromagnetike përkatesisht me pllaka të hekurit nga pjesa anësore e magnetit buron fusha antimagnetike e cila përbëhet nga tri mikrogrimca (β'), (δ') dhe (μ') të cilat prodhojnë gjatë fenomenit të rigjenerimit të protoneve, neutroneve dhe elektroneve.

Çka do të thotë se:

- 1) Protonet i prodhojnë mikrogrimecat (β') që i kam emëruar protoine (β'),
- 2) Elektronet i prodhojnë mikrogrimecat (δ') që i kam emëruar elektroine (δ') si dhe
- 3) Neutronet i prodhojnë mikrogrimecat (μ') që do t'i emërojë neutrinoine (μ')

Pasi protonet janë ngarkesa pozitive kjo tregon qartë se edhe mikrogrimecat (β') janë mikrogrimeca pozitive ($+ \beta'$), kurse elektronet pasi janë ngarkesa negative edhe mikrogrimecat (β') janë mikrogrimeca negative ($- \delta'$), kurse e vërmja arsy se pse nuk janë bërë këto simbolizime dhe emërtimi publike në vitin 2020 ka të bëjë me mikrogrimecën (μ')

që prodhohet nga neutroni.

(+ β') - Protoinet

(- δ') - Elektroinet

($x\mu'$) - Neutroinet Për x=?

Në këtë mënyrë simboli (μ') do ta shkruaj përmomentin ($x\mu'$), shenja (x) do ta vërtetojë se modeli standard i fizikës së grimave do të bie gjithsesi sapo të sqarohet dhe kuptohet neutroni.

Sqarim

Gjatë botimeve në gazeten "Epoka e re" 2016, 2019 dhe 2020 te fusha antielektrostatike që ka të bëjë me makrobotën, shumë qartë e kam sqaruar fushën antielektrostatike te elektroni dhe protoni, por nuk e kam sqaruar te neutroni. Prandaj neutroni do të sqarohet në një botim të ardhshëm të afërt të librit që do botohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze, si dhe do të ndryshohen tërësisht të dhënat shkencore mbi neutronin që njihen nga komuniteti shkencorë me të dhënat natyrale që do t'i japë unë mbi këtë grimcë enigmatike.

Fizikën e ndarë e bashkon fusha antimagnetike në makrobotë dhe fusha antielektrostatike në makrobotë

Përvetëm nga raportet e qendrave hulumtuese shkencore CERN dhe FERMILAB që e përmendin një grimcë të re apo vetëm një forcë të re fundamentalë, në zbulimet e mia shkencore që janë të botuara tregojnë qartë se kemi të bëjmë me dy forca fundamentale repulsive të fizikës.

1) Fusha antimagnetike si një

forcë repulsive që vepron në makrobotë, si dhe e dyta është 2) Fusha antielektrostatike si një forcë repulsive që vepron në makrobotë.

Por që të dyja fushat formohen nga mikrogrimecat e njëjtë (+ β'), (- δ') dhe ($x\mu'$), të cilat formojnë fushën antielektrostatike në makrobotë të gjitha elementet e materies, si formojnë fushën antimagnetike në makrobotë vetëm te elementet feromagnetike të materies.

Në këtë mënyrë duke u bazuar në raportet e dy qendrave hulumtuese shkencore CERN dhe FERMILAB që janë afër ta zbulojnë një forcë të re fundamentalë të fizikës, edhe pse nuk e theksojnë në mënyrë të quartë, fjala është përzbulimin e forcës së pestë fundamentalë të fizikës. Kuptohet se zbulimi i kësaj force fundamentalë të fizikës, na dërgon drejt njohjes reale të universit, krijimit, zhvillimit dhe gjendjes së tanishme të tij, përkatesisht zgjidhjes së problemit të energjisë së zezë dhe ekspansionit të universit, përvetëm që do t'i jepë një natyrale që do t'i përfshinë këtë grimcë enigmatike.

Por si do që të jetë një CERN dhe FERMILAB pretendojnë se kanë gjetur vetëm një forcë, do të thotë kanë gjetur forcën e pestë fundamentalë përmakrobotën problemi nuk zgjidhet, përkundrazi e thellojnë ndarjen e fizikës edhe shumë, sepse forca fundamentalë që vepron në makrobotë ka një lidhshmëri të pandarë me forcën fundamentalë që vepron në makrobotë, sepse që të dyja forcat kanë një gjeneratorë të njëjtë të tornadove elektromagnetike (aX+aZ) që i prodhojnë fushën elektrostatike në makrobotë dhe fushën magnetike në makrobotë, nga të cilat buron një fusha antielektrostatike, fusha antimagnetike aktivizohet vetëm në rrëthana të caktuara. Përvos që aktivizohet në rrëthana të caktuara, ajo aktivizohet vetëm te atomet e materialeve feromagnetike siç janë atomet e hekurit, kobaltit dhe nikelit. Shiko figurën (2).

Në këtë mënyrë fusha antimagnetike si një forcë repulsive në makrobotë ju kundërvihet forcave tërheqëse të cikloneve (aX+aY) të trupave qiellorë, me ç'rast arrihet deri te ekuilibri i forcave tërheqëse dhe repulsive te trupat qiellorë, dhe në këtë mënyrë arrihet stabiliteti në mbarë universin. Prandaj siç po shihet CERN-i European dhe Fermilab Amerikan më shumë shkojnë drejt ndarjes së fizikës se sa bashkimin e saj. Këto janë vetëm një pjesë që janë sqaruar shumë mirë në botimet e publikuara në "Epoka e re" 2019 dhe 2020.

(Vijon)

Lidhshmëria dhe dallimi në mes fushës antimagnetike në makrobotë dhe fushës antielektrostatike në makrobotë

Dallimi substancial i tyre është se fusha antielektrostatike që vepron në makrobotë, e ka burimin nga fusha elektrostatike që buron nga ngarkesat elektrike që ndodhen në brendësi të atomit, si dhe janë aktive te secili element përbërës i materies pa marrë parasysh gjendjen e ngurtë të lëngët apo të gaztë. Shiko figurën (1). Këto forca u kundërvihet forcave tërheqëse të cikloneve (aX+aY) në mes se cilës grimcë të atomit, me ç'rast arrihet stabiliteti i bërrhamës së atomit. Kurse ndryshtet fusha antielektrostatike që vepron në makrobotë, fusha antimagnetike që vepron në makrobotë te trupat qiellorë e ka burimin nga fusha magnetike e po atyre trupave qiellorë, kurse përvetëm nga fusha antielektrostatike, fusha antimagnetike aktivizohet vetëm në rrëthana të caktuara. Përvos që aktivizohet në rrëthana të caktuara, ajo aktivizohet vetëm te atomet e materialeve feromagnetike siç janë atomet e hekurit, kobaltit dhe nikelit. Shiko figurën (2).

Në këtë mënyrë fusha antimagnetike si një forcë repulsive në makrobotë ju kundërvihet forcave tërheqëse të cikloneve (aX+aY) të trupave qiellorë, me ç'rast arrihet deri te ekuilibri i forcave tërheqëse dhe repulsive te trupat qiellorë, dhe në këtë mënyrë arrihet stabiliteti në mbarë universin. Prandaj siç po shihet CERN-i European dhe Fermilab Amerikan më shumë shkojnë drejt ndarjes së fizikës se sa bashkimin e saj. Këto janë vetëm një pjesë që janë sqaruar shumë mirë në botimet e publikuara në "Epoka e re" 2019 dhe 2020.

(Vijon)

**Fusha antielektrostatike
është prezente te
atomet e të gjitha elementeve
që e përbëjnë materien**

$|(+\beta'), (-\delta'), (\chi\mu')|$
 $|(+\beta'), (-\delta'), (\chi\mu')|$
 $|(+\beta'), (-\delta'), (\chi\mu')|$

**Fusha antimagnetike
aktivizohet vetëm te
atomet e materialeve
Feromagnetike**

Fe $|(+\beta'), (-\delta'), (\chi\mu')|$
Co $|(+\beta'), (-\delta'), (\chi\mu')|$
Ni $|(+\beta'), (-\delta'), (\chi\mu')|$

Figura 1

Figura 2



Hysen Beqa lindi në Molliq të Gjakovës. Ka mbaruar studimet për shkencë politike dhe administratë publike në Universitetin e Prishtinës. Beqa është autor i romanit "Misiri i vogël", i cili nga gjuha shqipe është përkthyer në gjuhën angleze, franceze, gjermane, italiane dhe polake. Ky është libri i tij i dytë.

Ky libër, në rrafshin tematik, është vazhdim i romanit *Misiri i vogël*, i po të njëjtët autor, botuar tri vjet më parë, në të cilin autorit përsiat përvetë, për shoqërinë, për botën që e rrethon.

Këtë libër herë e lexojmë si fikcion, herë tjetër si jetëshkrim. Brenda tekstit gjemjë shenja të autorit, por edhe të narratorit. Ato që i rrëfen narratori janë ide të autorit, janë pikëpamje të tij për individët dhe shoqërinë. Heroi i romanit gjendet para shumë dilemave të mëdha të cilat ia krijon shoqëria.

Në këtë libër autorit trajton fatin e shkrimitarit dhe ballafaqimin e tij me shoqërinë. Përmes ndodhive personale, del sheshit fati i shkrimitarëve në shoqërinë e Kosovës. Nëse dikur shkrimitari ishte prijës popullor, sot ai është shtrësë e harruar nga shoqëria madje, nëpërmjet gojës së narratorit homodiegetik, shkrimitarët konsiderohen të çmendur dhe janë ose bëhen objekt talljeje. Por, nëpërmjet stoicizmit të narratorit Beqa mëton të tregojë se shkrimitaria nuk është thjesht një profesion a pasion, por mision.

Në këtë libër do të lexoni për politikën dhe për politikanët. Nuk do ta hasni autorin duke bërë politikë. Edhe pse nuk përmend emra të politikanëve dhe të politikave të këqija, është mjaft konkret, sepse përmend specifika të tyre. Këto raste të trajtuara për lexuesin semantik janë thjesht ide personale, kurse për lexuesin semiotik më tepër se kaq.

Albin Mehmeti

5.99€

ISBN 978-9951-780-53-7



SHKRIMTARI

HYSSEN BEQA

SHKRIMTARI



Kaltrina Pacolli
Prishtinë

UNË, KUFOMA E ARDHSHME

Zërin ngrite deri te Zoti.
Jetën mos ia fal askujt, përpos vetes.
Ti vlen sa gjithë bota, dhe bota pa ty është e mjerë.
Ti që botës i dhuron jetë, askush nuk ka të drejtë ta marrë atë nga ti.
Bërtit! Fol! Thuaje!

Unë jam gruaja më e fortë në botë!


ISBN 978-9951-780-49-0

9 789951 780490



6.99€

Kaltrina Pacolli





**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Ballkani përforcon kreun, Besa ndal Dritën

Ballkani e ka ruajtur pozitën e parë edhe pas derbit me Llapin, kurse Drita ka rënë në pozitën e tretë pas barazimit në Pejë kundër Besës. Fitores të mërkurën i është gjëzuar edhe Prishtina në përballje me Trepçën '89, kurse Gjilani ndau pikët me Drenicën

EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

Prishtinë, 28 prill - Katër ndeshjet e javës së 31-të në Superligën e Kosovës në futboll kanë qenë mjaft interesante. Skuadra e Ballkanit e ka përforcuar pozitën e parë, pasi e ka mposhtur në derbi Llapin me rezultat minimal 1-0. Ndesha e zhvilluar në Suharekë ishte mjaft interesante, por edhe e tensionuar. Gjyqtari kryesor në këtë ndeshje shpërndau tre kartonë të kuq. Golin e vetëm të ndeshjes e shënoi Bend Baftiu në minutën e 31-të. Pak minuta më vonë gjyqtari kryesor ndëshkoi me karton kuq Ahmed Januzin (Llap) dhe Kushtrim

Gashi (Ballkani). Në pjesën e dyte me karton të kuq u ndëshkua edhe Prençi. Rastet në vijim të ndeshjes nuk munguan, por rezultati mbeti i pandryshuar dhe Ballkani mori tri pikë. Ballkani është në vendin e parë me 67 pikë, kurse Llap është në vendin e pestë me 39 pikë. Kampionia në fuqi e Kosovës në futboll, Drita, ka bërë një hap fals në garën përfituar titull, pasi ka luajtur baras me Besën (1-1). Në minutën e 20 Ardi Tahiri me kokë shënoi golin e epërsisë për skuadrën pejane (1-0), ndërsa mysafirët e barazuani rezultatin në pjesën e dyte nëpërmjet Betim Haxhimusës, por kjo ishte e tëra që e arriti në këtë



ndeshje. Pas kësaj xhiroje, Drita bie në pozitën e tretë me 65 pikë. Në anën tjetër, Besa është e fundit me vetëm 11 pikë. FC Prishtina ka përfituar nga gabimi i Dritës dhe është ngrritur në vendin e dyte, pasi e ka mposhtur Trepçën '89 me rezultat 3-1. Kjo ndeshje u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri" dhe ishte mjaft interesante. Në pjesën e parë Prishtina humbi një penallti, kurse katër minuta pasi përfundoi pjesa e dyte

kryeqytetasit realizuan nëpërmjet Endrit Krasniqit. Leotrim Kryeziu e shënuar e përsinë e vendësve në 2-0, para se Arbnor Muja ta ngushtojë rezultatin me golin e shënuar nga penalltia. Leotrim Kryeziu e shënoi edhe golin e dyte personal dhe të tretin për Prishtinës (3-1). Kryeqytetasit pas tri pikëve të reja marrin pozitën e dyte dhe kanë grumbulluar 66 pikë, kurse Trepça '89 zë vendin e tetë me 35 pikë. Në ndeshjen tjetër,

SUPERLIGA - Java 31		
Prishtina - Trepça '89	3-1	
Gjilani - Drenica	0-0	
Ballkani - Llap	1-0	
Besa - Drita	1-1	
Feronikeli - Arbëria	0-1	
Tabela		
	Pikë	
1. Ballkani	31	67
2. Prishtina	31	66
3. Drita	31	65
4. Gjilani	31	44
5. Llap	31	39
6. Feronikeli	31	35
7. Drenica	31	35
8. Trepça '89	31	35
9. Arbëria	31	33
10. Besa	31	11

skuadra e Gjilanit ka ndarë pikët me Drenicën, pasi mbetën baras 0-0. Pas kësaj ndeshjeje Gjilani vazhdon të jetë në vendin e katërt me 43 pikë, kurse Drenica është e teta me 35 pikë. Të martën fitores i është gjëzuar Arbëria në përballje me Feronikelin (0-1).



City fiton me përbysje ndaj PSG-së

Paris, 28 prill - Manchester City hedh një hap drejt finales së madhe të këtij edicioni në Champions League. Skuadra e Pep Guardiolës ka arritur që të marrë një fitore 2-1 me përbysje ndaj PSG, por gjithçka është e hapur duke marrë në konsideratë faktin e mungesës së tifozëve. Ndesha nisi më mirë për skuadrën e Pochettinos që

gjeti golin e avantazhit në minutën e 15-të. Marquinhos shfrytëzoi një krosim magjik të Di Marias. Manchester City u zgjua në fillimin e pjesës së dyte, duke shënuar dy gola në harkun e 7 minutave përfituese përbysur gjithçka. De Bruyne realizoi me fat pas një krosimi në formën e një goditje, që nuk u arrit që të ndalej nga portieri Navas.

Gardiani i njohur u befasua edhe në golin e dyte pas një goditje dënimisë të Mahrez. Ky i fundit ekzekutoi mjaft mirë një goditje dënimisë, duke çarë murin e vendosur aspak mirë nga mbrojtja e ekipe franceze. PSG e mbylli ndeshjen me 10 lojtare pas ndëshkimit me karton të kuq të Gueye, i cili bëri një ndërryrje të ashpër ndaj Gundogan.

Kosova mposhtet nga Mali i Zi

Prishtinë, 28 prill - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll ka humbur ndeshjen kualifikuese përf "Euro 2022". Të mërkurën mbrëma në Prishtinë, Kosova u mposht nga Mali i Zi me rezultatin 27:22.

Përkundër humbjes, djemtë tanë shfaqën ndeshje të madhe. Ishte një përballje titanësh me luffë të pakompromis deri në minutat e fundit. "Dardanët" kanë shfaqur vlera ndaj malazezëve që

paraqiten në nivele të larta evropiane. Përfaqësuesja ka dëshmuan se tashmë është e konsoliduar, ndërsa kualifikimi nëndonjë ngjarje të madhe është çështje kohe.



Sonte vendoset titulli në Superligën e femrave

Prishtinë, 28 prill - Sot (e enjte) do të zhvillohet ndeshja e pestë finale e "play-off"-it në EBC Ligën e Femrave. Seria finale është 2:2 dhe kush fiton në përballjen e së enjtes do të shpallet kampion i Kosovës në elitën e femrave. Takimin e parë e fitoi Penza në Prizren

63:84, kurse sfidën e dyte në Pejë e fituan vashat prizrenase 65:70. Në takimin e tretë skuadra prizrenase fito sërisht 74:63, duke kaluar në epërsi 2:1, ndërsa ndeshjen e katërt e fitoi skuadra pejane 72:58, duke bërë që fituesi dhe kampioni të shpallet të enjten në

Prizren. Në garat e rregullta këto dy skuadra u ndeshen katër herë, ku tri herë fitoi Bashkimi dhe një herë Penza. Pas luftës Bashkimi e ka fituar gjashtë herë titullin kampion, kurse Penza e ka fituar tri herë. Ndesha Bashkimi - Penza zhvillohet nga ora 19:00.



Misioni i vështirë për Istogun, Trepça e dëshiron Superligën

PRISHTINË, 28 PRILL - Të enjten (nesër) do të zhvillohet ndeshja e dytë e "play-out" ndërmjet Trepçës dhe Istogut. Në "play-out" zhvillohen dy takime, ku kush është më e

mirë në këto dy përballje do të luajë në Superligë edicionin e ardhshëm. Takimi i parë përfundoj 70:99 në të mirë të mitrovicasve, që janë afër mbetjes në elitë, kurse

istogasit duhet të fitojnë me 30 pikë dallim në mënyrë që të hyjnë në elitën e basketbollit, që do të jetë një mision shumë i vështirë për skuadrën nga Istogu, që në Ligën e Parë në

garat e rregullta përfundoj në vendin e dytë, kurse 'xehetarët' u renditën në vendin e shtatë në FIVE STAR Superligë. Ndeshja Trepça - Istogu do të zhvillohet nga ora 17:00.



Sonte ndeshjet gjysmëfinale në Ligën e Evropës

UNITED, 28 PRILL - Skuadra favorite në Ligën e Evropës, Manchester United, e pret skuadrën e Romës në kuadër të ndeshjes së parë gjysmëfinale. Unitedi në çerekfinale e mposhti Granadën me rezultat të përgjithshëm 4-0 dhe tash synon që të marrë fitore në ndeshjen e parë në "Old Trafford" në mënyrë që të ketë me të lehtë ndeshjen kthyese në kryeqytetin italian. Në anën tjetër Roma e eliminoi Ajaxin me rezultat të përgjithshëm 3-2 dhe tash synon që të bëjë të njëjtën gjë edhe me Unitedin, por normalisht se kundërshtari i radhës është më i fuqishëm. "Është një sfidë e madhe, herët a vonë duhet të përballeshim me një ekip të shkëlqyeshëm. E kemi nisur Ligën e Evropës me mentalitet fituesi dhe duke menduar të çojmë trofeun në fund. Roma, gjithashtu, kërkon të fitojë. Ai nuk ka ardhur këtu për t'u argëtuar. Ne duhet të tregojmë se e duam trofeun më shumë se ajo", ka thënë mesfushori i Manchester Unitedit,



Paul Pogba.

Mungesat e Romës në këtë ndeshje janë Gianluca Mancini, Pedro dhe Nicolo Zaniolo, derisa në anën tjetër Unitedit i mungojnë Anthony Martial dhe Phil Jones. Në ndeshjen tjetër gjysmëfinale në Spanjë takohen, Villarreali dhe Arsenali. Të dyja këto skuadra e kanë synim kualifikimin në

Të enjten takohen:

21:00 Manchester United - Roma
21:00 Villarreal - Arsenal

finalen e madhe. Villarreali në çerekfinale e eliminoi Dinamo Zagrebin me rezultat të përgjithshëm 3-1, kurse Arsenali e eliminoi Slavian e Pargës me rezultat të përgjithshëm 5-1.

Brooklyni blindon vendin e parë në Lindje, fitojnë Bucksi dhe Mavericksi

TAMPA, 28 PRILL - Brooklyn Nets blindon vendin e parë në Konferencën e Lindjes me një tjetër fitore, e katërtë radhazi për skuadrën nju-jorkeze. Formacioni i drejtuar nga Steve Nash triumfoi në "Amalie Arena" ndaj Toronto Raptorsin me rezultatin 116-103, në një sfidë ku diferençën Brooklyni e bëri në periodën e fundit, 12-minutësh në të cilin Netsi shënoi 16 pikë më shumë. Jeff Green me 22 pikë e 8 rebounde ishte më i miri mbi parket për Brooklynin, ndërsa ndihmuani në këtë fitore edhe Kevin Durant i Blake Griffin me nga 17 pikë secili. Për Toronton spikati Kyle Lowry me 24 pikë, por pa mundur ta evitojë humbjen. U rikthye menjëherë te suksesi Milwaukee Bucks që triumfoi në transfertën ndaj Charlotte Hornets me rezultatin 114-104 ndeshje në të cilën spikati i përhershmi Giannis Antetokounmpo me 29 pikë, 12 rebounde dhe 8 asistime. Me 38 fitore dhe 23 humbje në 61 ndeshje Milwaukee aktualisht pozicionohet



në vendin e 3-të në Lindje dhe me shumë gjasa do ta mbylli sezzonin e rregullt në këtë pozicion. Në kritë rezultatesh Boston Celtics që pësoi disfatën e 4-të në 5 ndeshjet e fundit pasi u mposht në "TD Garden" nga Oklahoma City Thunder me shifrat e ngushta 115-119. Jaylen Brown shkëlqeu në këtë sfidë duke realizuar plot 39 pikë, por që gjithsesi nuk u mjaftuan 16 herë kampionëve të NBA-së për ta

evitar humbjen e radhës. Falë një super Luka Doniqiq Dallas Mavericks mposhti lehtësisht brenda në San Francisco me rezultatin 133-103, Golden State Warriors. Për ta udhëhequr Dallasin drejt fitores së 4-të në 5 ndeshjet e fundit, basketballisti sloven koleksionoi 39 pikë, 6 rebounde dhe 8 asistime, ndërkohë që te Golden State spikati Stephen Curry me 27 pikë.

Juve planifikon rikthimin e Allegrit

Andrea Pirlo nuk do të jetë trajner i Juventusit sezzonin e ardhshëm, edhe nëse do të sigurojë një vend në zonën e Ligës së Kampionëve. Ashtu si një sezoni më parë, kur u

njoftua se Sarri do të qëndronte, por më pas u detyrua që të largohej. E ardhja fillimisht do të luhet në Udine për Pirlon, teksha vendin e tij në sfidat e fundit mund ta mbajë

Tudor për t'ia lënë më pas Massimiliano Allegrit. Te bardhezintë ka ardhur momenti që të fitohet sërisht. Ky është motivi që drejtuesit të mendojnë rikthimin e

SHKURT

Më 6 qershor dueli Mayweather - Paul

Dueli "show" i boksit mes Floyd Mayweather dhe Logan Paul do të zhvillohet më 6 qershor në Majemi. Tashmë gjithçka është zyrtare dhe është konfirmuar nga të dyja palët. Kjo sfidë duhet të ishte zhvilluar në shkurt, por u shty pa afat, ndërsa tashmë ka një datë zyrtare. Mayweather rikthehet në ring pas gati dy vjetësh pushim, që nga dueli i fundit "show" zhvilluar në nëntor 2019 ndaj japonezit Tenshin Nasukawa. Kjo përballje me Paulin, një personazh i njohur i YouTubes, do të zhvillohet në stadiumin "Rock Hard Arena" të Majemit. Nga kjo sfidë pritet që Mayweather të arkëtojë një shumë të mirë parash.

PSG-ja i ofron Messit kontratë trevjeçare

Paris Saint-Germaini është seriozisht i interesuar për të transferuar Leo Messin. Mediat franceze raportojnë se klubi nga Parisi i ka bërë ofertë zyrtare yllit të Barcelonës, në të cilën përfshihet kontrata trevjeçare. Kontrata e Messit me Barcelonën përfundon në fund të këtij sezoni dhe argentinasi ende nuk e ka rinovuar. Ndryshe në "Camp Nou" janë të bindur se lojtari më i mirë i tyre nuk do të largohet.

Marcelo: Jemi të qetë, do të bëjmë ndeshje të mirë në Londër

Marcelo, kapiteni i Real Madridit, ka folur pas barazimit 1-1 me Chelsean në ndeshjen e parë në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. Reali nuk arriti që ta fitojë sfidën e parë dhe tanë i duhet patjetër barazimi prej 2 e më shumë gola nëse e dëshiron finalen, derisa Chelsea me 0-0 siguron biletën për në finale. "Jemi mirë dhe të qetë. Do të bëjmë ndeshje të mirë në Londër. Këtu punojmë të gjithë shumë dhe do të vazhdojmë edhe për ndeshjen e kthimit. Real Madridi do të luftojë deri në fund", ka thënë Marcelo.


